

V E N D I M
Nr.230, datë 22.5.1999

PËR STRUKTURËN DHE ORGANIKËN ANALITIKE TË ADMINISTRATËS DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8849, datë 27.1.1999 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe organika analitike e administratës doganore është sipas lidhjeve nr.1 dhe nr.2, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Punonjësit e administratës doganore klasifikohen në këto kategori:
 - I. Kategoria A:
 - drejtor drejtorie në departament;
 - drejtor drejtorie rajonale.
 - II. Kategoria B
 - përgjegjës sektori, kryetar dege doganore;
 - inspektor kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm.
 - III. Kategoria C1:
 - specialist, hetues doganor, drejtues turnesh.
 - IV. Kategoria C2:
 - doganier.
 - V. Kategoria D1:
 - pranues, regjistruar deklarata doganore, llogaritar-arkëtar, magazinier, operator, laborant, sekretar, arkivist.
 - VI. Kategoria D2:
 - centralist, sportelist, shofer, sanitar dhe mirëmbajtës.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave që, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të hartojë deri më 30.6.1999 strukturën e re të pagave të administratës doganore, në përputhje me strategjinë e miratuar për pagat në administratën publike në Republikën e Shqipërisë.
 4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 15 maj 1999.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko